



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.29 dt.14.02.1997

**MBI
STRUKTURIMIN E QENDRES EKONOMIKE TE KULTURES**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kulturës për ristrukturimin e Qendrës Ekonomike të Kulturës si një institucion për lëvizjen kulturore artistike masive dhe për ndjekjen e problemeve financiare për veprimtarinë e mësipërme mbështetur në ligjin “Për organet e pushtetit lokal”neni.14, pika.9,

V E N D O S I;

1. Të ristrukturohet Qendra Ekonomike e Kulturës duke u unifikuar në një të vetme Ndërmarrje e Dekorit dhe Qendra Ekonomike e Kulturës.
2. Fuqia punëtore si për ata buxhetorët dhe për ata me vetëfinancim mbetet ajo ekzistuesja, ndërsa ekipi drejtues i Qendrës Ekonomike ngrihet në nivel Drejtorie.
3. I lihet kompetencë Drejtorisë të bëjë strukturat e brendëshme përkatëse.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

ORHAN SAKIQI

